



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2320/ 15 prot

Datë 30.12.2022

**V E N D I M**  
**Nr. 1310/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.12.2022, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr REF-36265-07-13-2022 me objekt “*Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë*” me fond limit 1,580,419.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 25-07-2022 nga autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë Tirane.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Inpress” SHPK  
*Adresa: Rruga: “Siri Kodra”, ish blloku i magazinave, Tiranë*
- Autoriteti Kontraktor:** Universiteti i Mjekësisë Tirane  
*Adresa: Rruga e Dibrës, Nr. 371, 1005 – Tiranë*
- Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “F.L.E.SH Shtëpi Botuese” SHPK  
*Adresa: Rr. Sulejman Pitarka, Ish Merkato 21 Dhjetorit, Banesa Private nr.2*
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave

nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 14-07-2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr REF-36265-07-13-2022 me objekt “Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë” me fond limit 1,580,419.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 25-07-2022 nga autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë Tirane.

II.2. Në datën 25.07.2022 , autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 21.11.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si më poshtë:

1. “Inpress ” SHPK	91,178.00 lekë	skualifikuar
2. “F.L.E.SH Shtepi Botuese ” SHPK	1.009.960 lekë	kualifikuar
3. “Onufri ”SHPK	1.190.310 lekë	kualifikuar
4. “Albdesign PSP” SHPK	1.327.376 lekë	kualifikuar

5. “Dynmicx Group” SHPK

1.496.905 lekë

skualifikuar

II.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se autoriteti kontraktor më datë 21.10.2022 ka publikuar Njoftim-Fituesin për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 24.10.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur në mënyrë elektronike në Sistemin e Ankesave Elektronike ankesa me nr. A/2022/2632 , protokolluar me nr. 2320/2022 datë 24.10.2022 e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit sipercituar duke ankimuar arsyet e skualifikimit të tij.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2320/2prot datë 25.10.2022.

II.7 Operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK protokolluar me tonën date 25.10.2022 me nr 2320/3 dergon shkresën percjellse me lendë “ Dorëzohet kopje e njehsuar me origjinalin nga noteri publik i dokumentiti “vertetim Debie” (Per pagesat e energjise elektrirke”.

II.8 Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, ka operate ekonomik i interesuar në përputhje me nenin 113 të LPP-së, pranë Komisionit të Prokurimit Publik në formë shkresore nr prot 2320/4 datë 27.10.2022 nga operatori ekonomik “F.L.E.SH Shtepi Botuese”. SHPK me objekt “ Pavlefshmeri e ankeses se operatorit ekonomik “Inpress” SHPK.

II.9 Me shkresën nr.1884/52 prot, datë 02.11.2022, protokolluar me tonën me nr.2320/5 prot. 03.11.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës ose shtimin e arsyeve së paraqitur nga operatori ekonomik “F.L.E.SH Shtepi Botuese dhe Shtypshkronje” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi i ankesës.

II.10. Me shkresën nr. 1884/55 prot, datë 03.11.2022 , protokolluar me tonën me nr.2320/6 prot. 07.11.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi i ankesës duke cituar “[...]Pranimin pjeserisht te ankeses te Operatorit Ekonomik Inpress Sh.p.k me NUIS: L52122014L;

1. *Konsiderimin te plote dhe te rregullt te Vertetimit te Debise "Për operate ekonomik për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik ..." me nr.5153/1 prot., date 21.07.2022 leshuar nga Furnizuesi i Sherbimit Universal (FSHU - OSHEE GROUP*

*SHA), njësuar me originalin ne zyrën e noterit Majlinda Demollari sipas Vertetimit te njesimit me originalin, leshuar nga kjo notere me Nr Rep 8528, date 21.10.2022.*

- 2. Kerkesat e tjera te OE Inpress" shpk nuk pranohen nga KSHA pasi nuk jane ne kompetencat e saj.*
- 3. Ky procesverbal i njoftohet menjehere Titullarit te A.K.-se;*
- 4. Ky procesverbal mbahet në2 (dy) kopje, 1 (nje) kopje për Dosjen e Prokurimit dhe 1 (nje) kopje per Sektorin e Protokoll-Arkives.[..].*

II.11. Komisioni Prokurimit Publik ne lidhje me oferten anomalisht te ulet operatori ekonomik "Inpress" SHPK në datën 16.08.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ka paraqitur në mënyrë elektronike në Sistemin e Ankesave Elektronike ankesen me nr. A/2022/2446 , protokolluar me nr. 1773/2022 datë 16.08.2022 e "Inpress" SHPK për procedurën e prokurimit të të mësipërm, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.12 Ne daten 07.09.2022 Komisioni Prokurimit Publik del me vendimin nr 860/2022 ku citon:

- 1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga "Inpress" SHPK për procedurën e prokurimit "E hapur, e thjeshtuar", me nr REF-36265-07-13-2022 me objekt "Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë" me fond limit 1,580,419.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 25-07-2022 nga autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë Tirane.*
- 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.*
- 3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga "Inpress" SHPK.*
- 4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.13 Me shkresën Nr 2320/7 datë 15.11.2022 Komisioni Prokurimit Publik i drejtohet autoritetit kontraktor, Universiteti i Mjekësisë Tirane me kërkesën për informacion si më poshtë: *Ne datën 07.11.2022 , ne forme shkresore eshte nioftuar Komisioni i Prokurimit Publik se ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik "Inpress" SHPK, eshte trajtuar nga autoriteti kontraktor, dhe me and te vendimit nr. 1884/55, date 31.11.2022, ka vendosur pranimin e saj.*

*Sa me sipër, krahas informimit te sipërcituar, duhet te paraqitet ne menyre shkresore informacion i hollesishëm mbi hapat procedural te marra nga autoriteti kontraktor për procedurën objekt ankimi, komunikimet midis autoritetit kontraktor de operatorëve ekonpomike, dokumentacionin mbi oferten anomalisht te ulet, fazen ne i cilen ndodhet procedura e prokurimit, apo do dokumentacion tjetër, ne perputhje me percaktimet e nenit 114 te ligjit nr. 162/2020 ". Per Prokurimin Publik, lidhur me trajtimin e ankesës se operatoritekonomik ankimues "Inpress" SHPK.*

II.14.Me shkresën nr.1884/57 , datë 30.11.2022, protokolluar me tonën me nr.2320/8 prot. 01.12.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me hapat procedural te ndermarra nga autoriteti kontraktor per procedure

objekt ankimi, komunikimet me operatoriet ekonomik, inofmracion te hollesishim mbi procedure objekt ankmimi.

II.15 Ne datën 02.12.2022 nr prot 2320/9 Komisioni Prokurimit Publik i drejtohet autoritetit kontraktor, Universiteti i Mjekesise Tirane me kërkesën për informacion duke qene si subjekt i interesuar pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi operatori ekonomik “F.L.E.SH. Shtepi botuese” SHPK a eshte njoftuar mbi vendimarrjen e Autoritetit kontrkaotr ne lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ‘Inpress’ SHPK

II.16 Ne daten 06.12.2022 me nr prot 1884/59 protokolluar me tonen 2320/10 datë 09.12.2022 prane Komisionit Te Prokurimit Publik protokollohet shkresa e autoritetit kotraktor me lende ‘ Kthim pergjigje mbi kërkesen per informacion të KPP-Së Nr.2320/9 datë 02.12.2022 duke cituar se [...]Ne vijim te shkresës suaj nr. 2320/9 prot., date 02.12.2022, administruar prane Rektoratit te Universitetit te Mjekesise, Tirane me nr. 1884/58 prot., date 05.12.2022, me objekt "Kerkesë për informacion", ju informojme se:

*Ne lidhje me pikën 1, ju bejme me dije se operatori ekonomik "F.L.E.SH. Shtepi Botuese" SHPK nuk ka paraqitur argumenta prane institucionit tone. Ky operator ka paraqitur ankesë me nr. 1884/48 prot., date 27.10.2022 me objekt "Kerkese derguar KVO per tenderin e diplomave të UMT", per te cilen me shkresën nr. 1884/52 prot., date 01.11.2022 "Kthim pergjigje" ka marrë pergjigje për ankesën e paraqitur, nje kopje e ketij komunikimi e gjeni bashkelidhur. Në lidhje me piken 2, operatori ekonomik "F.L.E.SH. Shtepi Botuese" SHPK nuk eshte njoftuar mbi vendimin e KSHA-se lidhur me ankesën e operatorit ekonomik "Inpress" SHPK, pasi objekt i ankeses ka gene vendimi i Komisionit te Vleresimit te Ofertave de nuk ka pasur ankesë ne lidhje me operatorin ekonomik "F.L.E.SH. Shtepi Botuese" SHPK[...].*

II.17 Ne datën 13.12.2022 nr prot 2320/11 Komisioni Prokurimit Publik i drejtohet autoritetit kontraktor, Universiteti i Mjekesise Tirane duke qene si subjekt i interesuar pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi operatori ekonomik “F.L.E.Sh Shtepi Botusesë” SHPK, me kërkesën për informacion duke cituar se ‘[...]Në datën 24.10.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur në mënyrë elektronike në Sistemin e Ankesave Elektronike ankesa me nr. A/2022/2632 , protokolluar me nr. 2320/2022 datë 24.10.2022 e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr REF-36265-07-13-2022 me objekt “Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë” me fond limit 1,580,419.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 25-07-2022 nga autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekesise Tirane.

*Operatori ekonomik “Inpress” SHPK kundërshton vendimin e autoritetit kontraktor mbi skualifikimin e ofertës të tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi.*

*Bazuar në nenin 113 dhe 114 pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” kërkojmë të informoni për si më poshtë:*

*1.Te informoni operatorin ekonomik “F.L.E.SH Shtëpi Botuese” SHPK si subjekt i interesuar pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi në lidhje me vendimarrjen mbi ankesën e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK.*

*Me qëllim vijimin e shqyrtimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të ligjit nr.162/2020, "Për prokurimin publik", duhet të dërgoni pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar bashkelidhur shkresen informuese per operatorin ekonomik "F.L.E.SH Shtëpi Botuese" SHPK, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese.[...].*

II.18 Ne datën 15.12.2022 me nr prot 1884/61 protokolluar me tonen 2320/12 datë 16.12.2022 prane Komisionit Te Prokurimit Publik protokollohet shkresa e autoritetit kontraktor me lende 'Lenda: Informacion " Mbi zbatimin e kerkesës sëK.P.P.-se me shkresën Nr. 2320/11 Prot., date 13.12.2022, per proceduren e prokurimit, me REF-36265-07-13-2022. me objekt: "Prodhim dhe printim diplomash për njesite shpenzuese te Universitetit te Mjekësise, Tiranë "

II.19 Në datën 21.12.2022 nr prot 2320/13 Komisioni Prokurimit Publik i drejtohet autoritetit kontraktor, Universiteti i Mjekesise Tirane duke qene si subjekt i interesuar pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi operatori ekonomik "F.L.E.Sh Shtëpi Botuese" SHPK, me kërkesën për informacion me lende "Kerkese Per informacion".

II.20 Në datën 28.12.2022 me nr prot 1884/63 protokolluar me tonen 2320/14 datë 29.12.2022 prane Komisionit Te Prokurimit Publik protokollohet shkresa e autoritetit kontraktor me lende " Informacion mbi zbatimin e Kerkestes per informacion (K.P P-se me shkresen Nr. 2320/13 Prot., date 21.12.2022, për procedurën e prokurimit, me REF-36265-07-13-2022. me objekt: "Prodhim dhe printim diplomash për njesitë shpenzuese te Universitetit te Mjekësise, Tiranë", ku bashkelidhur dokumentacioni me nr prot 1884/61 date 15.12.2022 ku citohet: Lenda: Informacion" Mbi zbatimin e kerkesës se K.P.P.-se me shkresën Nr. 2320/11 Prot., date 13.12.2022, per proceduren e prokurimit, me REF-36265-07-13-2022. me objekt: "Prodhim dhe printim diplomash për njesite shpenzuese te Universitetit te Mjekesis, Tiranë "

*OPERATORIT EKONOMIK F.L.E.SH. sh.p.k., me N.U.I.S. J91801004M Rruga Nikolla Lena, ish Merkato e "21 Dhjetorit", Tiranë*

*KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK Bly "Deshmorat e Kombit", Pallati Kongreseve, Kati i I-re, Tirane*

*Ne zbatim te Kerkeses për Informacion " Mbi zbatimin e kerkesës se K.P.P.-se me shkresën Nr. 2320/11 Prot., date 13.12.2022, për procedurën e prokurimit, me REF-36265-07-13-2022. me objekt:*

*"Prodhim dhe printim diplomash per njesite shpenzuese te Universitetit te Mjekesise, Tirane", ardhur ne rruge elektronike me date 13.12.2022, ora 11.08, pranë Institucionit tone, bashkelidhur keni: Vendim te K.S.H.A., me nr. 1884/53 prot., date 02.11.2022, me objekt: „ Vendim per shqyrtim te Ankeses se operatorit ekonomik „INPRESS\* sh.p.k., me N.U.IS. L52122014L, me Formular Ankese me nr. ref. - 36265-07-13-2022 dhe shkresen percjellese te operatorit ekonomik „INPRESS\* sh.p.k., protokolluar prane U.M.T.-se me nr. 1884/47, date25.10.2022, ne procedurën e prokurimit, me REF-36265-07-13-2022. me objekt: "Prodhim dhe printim diplomash per njesite shpenzuese te Universitetit te Mjekësise, Tiranë" - Shkresen me nr. 1884/55 Prot., date 03.11.2022, te Titullarit te Autoritetit Kontraktor, me objekt: „ Kthim pergjigje ankeses se operatorit ekonomik „INPRESS" sh.p.k., n° proceduren e prokurimit, me REF-36265-07-13-2022. me objekt: "Prodhim dhe printim diplomash per njesite shpenzuese te Universitetit te Mjekësise, Tiranë[.]*

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

### **Arsyeton:**

III.1 Lidhur me pretendimin e ankimuesit me kërkesën mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK në procedurën e prokurimit. , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar vendimit nr. 1884/55 prot, datë 03.11.2022 ,per ankesën e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se ankesa është pranuar si më poshtë vijon; “[...]Pranimin pjesërisht te ankeses te Operatorit Ekonomik Inpress Sh.p.k me NUIS: L52122014L;

1. *Konsiderimin te plote dhe te rregullt te Vertetimit te Debise "Për operatoret ekonomik për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik ..." me nr.5153/1 prot., date 21.07.2022 leshuar nga Furnizuesi i Sherbimit Universal (FSHU - OSHEE GROUP SHA), njësuar me originalin ne zyrën e noterit Majlinda Demollari sipas Vertetimit te njesimit me originalin, leshuar nga kjo notere me Nr Rep 8528, date 21.10.2022.*
2. *Kerkesat e tjera te OE Inpress" shpk nuk pranohen nga KSHA pasi nuk jane ne kompetencat e saj.*
3. *Ky procesverbal i njoftohet menjehere Titullarit te A.K.-se;*

*Ky procesverbal mbahet në2 (dy) kopje, 1 (nje) kopje për Dosjen e Prokurimit dhe 1 (nje) kopje per Sektorin e Protokoll-Arkives.*

III.1.2..Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se ka operatore ekonomik i interesuar, operatori ekonomik “F.L.E.SH Shtepi Botuese” SHPK në përputhje me nenin 113 të LPP-së, pranë Komisionit të Prokurimit Publi keshte depozituar në formë shkresore me ledne “Pavlefshmeri e ankeses se operatorit ekonomik “Inpress” SHPK.”

III.1.3.Pas disa komunikumesh ne forme shkresore nga ana e Komisionit te prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor ne lidhje me njoftimin e operaorit ekonomik si subjekt i interesuar F.L.E.SH shtepi Botuese; SHPK per lajmerimin mbi vendimarrjen e Autoritetit kontraktor ne lidhje me pranimin e ankeses se operaorit ekonomik “ Inpress” SHPK, Autoriteti kontrkaor me shkresen nr prot 2320/14 datë 29.12.2022 prane Komisionit Te Prokurimit Publik protokollohet shkresa e autoritetit kotraktor me lende “ *Informacion mbi zbatimin e Kerkestes per informacion (K.P P-se me shkresen Nr. 2320/13 Prot., date 21.12.2022, për procedurën e prokurimit, me REF-36265- 07-13-2022. me objekt: "Prodhim dhe printim diplomash për njesitë shpenzuese te Universitetit te Mjekësise, Tiranë”,* ku bashkelidhur dokumentacioni me nr prot 1884/61 date 15.12.2022 ku citohet: *Lenda: Informacion" Mbi zbatimin e kerkesës se K.P.P.-se me shkresën Nr. 2320/11 Prot., date*

13.12.2022, per procedurën e prokurimit, me REF-36265-07-13-2022. me objekt: "Prodhim dhe printim diplomash për njesite shpenzuese te Universitetit te Mjekesis, Tiranë "

OPERATORIT EKONOMIK F.L.E.SH. sh.p.k., me N.U.I.S. J91801004M Rruga Nikolla Lena, ish Merkato e "21 Dhjetorit", Tiranë KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK Bly "Deshmorat e Kombit", Pallati Kongreseve, Kati i I-re, Tirane Ne zbatim te Kerkeses për Informacion " Mbi zbatimin e kerkesës se K.P.P.-se me shkresën Nr. 2320/11 Prot., date 13.12.2022, për procedurën e prokurimit, me REF-36265-07-13-2022. me objekt:

"Prodhim dhe printim diplomash per njesite shpenzuese te Universitetit te Mjekesise, Tirane", ardhur ne rruge elektronike me date 13.12.2022, ora 11.08, pranë Institucionit tone, bashkelidhur keni: Vendim te K.SH.A., me nr. 1884/53 prot., date 02.11.2022, me objekt: „ Vendim per shqyrtim te Ankeses se operatorit ekonomik „INPRESS\* sh.p.k., me N.U.IS. L52122014L, me Formular Ankesë me nr. ref. - 36265-07-13-2022 dhe shkresën percjellese te operatorit ekonomik „INPRESS\* sh.p.k., protokolluar prane U.M.T.-se me nr. 1884/47, date 25.10.2022, ne procedurën e prokurimit, me REF-36265-07-13-2022. me objekt: "Prodhim dhe printim diplomash per njesite shpenzuese te Universitetit te Mjekësisë, Tiranë" - Shkresën me nr. 1884/55 Prot., date 03.11.2022, te Titullarit te Autoritetit Kontraktor, me objekt: „ Kthim pergjigje ankeses se operatorit ekonomik „INPRESS" sh.p.k., n° proceduren e prokurimit, me REF-36265-07-13-2022. me objekt: "Prodhim dhe printim diplomash per njesite shpenzuese te Universitetit te Mjekësisë, Tiranë[.]

III.1.4 Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.5 Neni 114 pika e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: 1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.



3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.6. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

- i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
- ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.7 . Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se operatori ekonomik "F.L.E.Sh Shtepi Botuese " SHPK ka paraqitur argumente në cilësinë e subjektit të interesuar në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" në autoritet kontraktor, ashtu si dhe praë Komisionit të prokurimit Publik. Autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik "F.L.E.SH Shtepi Botuse" SHPK mbi pranimin e ankesës së operatorit ekonomik "Inpress" SHPK.

Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të shkresës nr1884/55 prot, datë 03.11.2022 , protokolluar me tonën me nr.2320/6 prot. 07.11.2022 KPP konstaton, se autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë Tirane e ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi. Në këto kushte, bazuar në pikën 3 të nenit 115 të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Inpress" SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 , pika 1 dhe 3 e nenit 115 dhe neni 118 i ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2018 "Për miratimin e rregullave "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Inpress" SHAPK, për procedurën e prokurimit "E hapur, e thjeshtuar" me nr REF-36265-07-13-2022 me objekt "Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë" me fond limit 1,580,419.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 25-07-2022 nga autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë Tirane.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Inpress" SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**

**Fiorent Zguro**

**Anëtar**

**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**

**Jonaïd Myzyri**